




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpcë

Komuna e Shterpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shterpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/11/2022 miratoi këtë :

#### V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 28.10.2022

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
  
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





|                                      |                                   |
|--------------------------------------|-----------------------------------|
| REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS | OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS |
| IZLAZNI - DALËSE                     |                                   |
| 018 P.                               | 01-020 08-16133/22                |
| Nr.Prot.                             |                                   |
| Bnr.                                 |                                   |
| Nr. f.                               |                                   |
| Datum                                | 05.12.2022.                       |
| Data                                 |                                   |
| ŠTRPCE - SHTËRPCË                    |                                   |



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republik of Kosovo

Skupstina opštine štrpcce

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës

Municipality of Strpce

## PROCESVERBAL

Nga seanca e pestë e rregullt e KK-ës të mbajtur më 28.10.2022, me fillim në ora 10:00 h.

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca paraprake e Kuvendit të Komunës së Shtërpcës;
3. Zgjedhja e nënkyrytarit të komunës për komunitete
4. Prezantimi i raportit finansiar nëntëmujor për periudhën janar - shtator 2022
5. Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksat komunale
6. Të ndryshme.

Seanca e shtatë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Shtërpcës filloi me konstatimin e kryetarit të Kuvendit, z. Predrag Grbiq se të pranishëm janë të 15 këshilltarët dhe pastaj filluan me pikën e parë të rendit të ditës:

**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës**, ku askush nuk është lajmëruar për fjalë, kjo pikë u miratua unanimisht.

Pika tjeter ishte

Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit të Komunës së Shtërpcës, ku z. Kostiq ka pasur vërejtje, duke thënë se një pjesë e fjalimit tim është hequr nga procesverbalit dhe se i gjithë kuptimi i asaj që ka thënë ka humbur sepse në pjesën e dytë të prezantimit të tij ku ka cituar atë që shkruhej në procesverbal: "një gjë tjeter që ai kundërshtoi ishte tatimi në paluajtshmëri që paguhet dhe ka konsideruar se nuk është e drejtë dhe se kështu është në nivel të tërë Kosovës", ku më tej ka thënë se sipas asaj që është shkruar ka dal që ka thënë që është kundër pagimit të tatimit që nuk është e vërtetë dhe ai ishte i mendimit se ishte bërë pa dashje. Ai më pas ka theksuar se në pjesën e dytë të prezantimit të tij ka thënë se është gabim të paguhet

tatimi në pronën e paluajtshme, d.m.th. mbi shtëpinë dhe në të njëjtën kohë të paguajë taksën në truallin ku ndodhet shtëpia.

Më pas procesverbali u miratua unanimisht

**Zgjedhja e nënkryetarit të komunës për komunitete**, ku nënkryetari Ivica Tanasijeviq ishte autorizuar nga kryetari z. Dalibor Jevtiq, për shkak të mungesës së arsyetuar dhe, nënkryetari i komunës ka propozuar z. Fikri Hasani për Nënkryetar për Komunitete. Më pas u hedh në votim propozimi.

Z. Fikri Hasani është zgjedhur nënkryetar për komunitete me 14 vota për dhe 1 abstenim.

Pasi iu dërguan urime, Më pas z. Fikri i falënderoi ata për zgjedhjen e tij dhe shprehu shpresën se do të bashkëpunojnë si më parë në planin ekonomik dhe që tash e tutje qytetarët të kenë adresën e duhur ku mund të drejtohen për të gjitha problemet e tyre.

Pika tjetër ishte:

**Prezantimi i raportit finanziar nëntëmujor për periudhën janar - shtator 2022**, ku drejtori i financave z. Gjorgje Gjorgjeviq, mori fjalën, i cili tha se në raport janë prezantuar 17 programe buxhetore dhe janë dhënë informacione të detajuara për 5 programe buxhetore dhe janë dhënë informacione të tjera të përgjithshme për shpenzimet. Ai ka theksuar se buxheti i komunës është 3,871,348€. më pas dka thënë se si duket ajo shpërndarje sipas të gjitha kategorive me të cilat këshilltarët tashmë ishin njobur, duke marrë parasysh faktin se të gjitha i kishin marrë tashmë në materialin që u ishte përcjellë. Ai theksoi se përveç gjithë asaj që u përmend më lart, buxheti për vitin 2023 është 4,415,053€. Më tej ai tha se në faqen 5 janë dhënë informata lidhur me shpenzimet buxhetore me alokime. Ai po ashtu tha se të hyrat vetanake të planifikuara janë 558,511€ dhe se deri më tani janë mbledhur 289,343€ ose 51%. Ai më tej tha se informacionet lidhur me të hyrat janë dhënë në tabelat që janë në këtë raport, si dhe krahasimet e të hyrave vetanake nga viti paraprak me këtë vit. Ai tha se në këtë raport jepen informacione të detajuara dhe nëse dikush ka ndonjë pyetje mund të bëjë lirisht.

Fjalën e mori z. Slavisha Vasiljeviq, i cili theksoi se ky raport është përgatitur në atë formë që ofron vetëm informata themelore se si komuna, përkatësisht autoriteti ekzekutiv, e ka shpenzuar buxhetin e qytetarëve të komunës së Shtërpcës, por pa informata themelore se si dhe në çfarë mënyre është shpenzuar buxheti dhe se ato shifra që i shohim në tabelë nuk nënkuftojnë asgjë sepse nuk ka një përshkrim të qartë se si janë shpenzuar paratë për mallra dhe shërbime, për projekte kapitale, për paga në arsim, në shëndetësi. Ai theksoi se të njëjtin kundërshtim e kishte edhe kur po miratohej rapporti gjashtëmujor dhe se nuk ishte marrë fare parasysh. Ai më tej tha se është marrëzi të miratohet një raport i tillë nëse ata si këshilltarë nuk e dinë se si dhe në çfarë mënyre janë shpenzuar paratë. Ai po ashtu tha se pika e radhës ka të bëjë me taksat komunale dhe duke ditur që qytetarët e mbushin buxhetin komunal, do të ishte e drejtë që t'u jepej komente se si po shpenzohet buxheti dhe në fund theksoi se nuk do të votojë një raport të tillë nga arsyet e lartpërmendura.

Z. Miroslav Gjorgjeviq ka marr fjalën, ku tha se ky raport nuk votohet dhe më tej theksoi se në periudhën paraprake kishte qenë disa herë të drejtori e financave për të marrë informacione për

gjërat që i kanë interesuar, ku ai më tej doli në përfundimin se raporti ishte përgatitur në formë korrekte dhe se nuk kishte vërejtje dhe se nëse ndonjëri nga këshilltarët ishte i interesuar për një çështje specifike, ai ishte i mendimit se drejtori do të ndante çdo informacion me të gjithë. Shifrat janë aty, tha ai, dhe nëse do të thotë diçka për dikë apo jo është diçka tjetër, dhe rekomandimi i tij ishte që çdo këshilltar që dëshiron mund të shkojë te drejtori sepse të gjithë do të priten mirë.

Më pas është kaluar në pikën tjeter, duke qenë se raporti finançiar nuk votohet.

**Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksat komunale** ku drejtori i administratës z.Havzi Ahmeti: siç tha kryesuesi, çdo akt i kuvendit të komunës që miratohet në kuvend i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal (MPL), në këtë rast, pasi që Rregullorja përfshin fushat nga institucionet më të larta. që mbikëqyrin këtë akt, kështu që Rregullorja i është dorëzuar MPL-së në 8 institucione tjera për të siguruar dëshmitë e tyre për këtë rregullore. Kjo Rregullorja është vlerësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të tjera, kanë dhënë vlerësimin e tyre për ligjshmërinë e Aktit të Kuvendit të Komunës. Për propozimet dhe sugjerimet jam njoftuar me e-mail, kam pasur nevojë për konsultim me zyrat juridike të këtyre institucioneve, pasi që propozimet dhe sugjerimet kanë të bëjnë me vazhdimin e procedurës për hartimin e kësaj Rregulloreje. Për t'ju bërë më të lehtë të shihni se ku janë bërë ndryshimet, ato janë shënuar me të kuqe në rregullore. Është e rëndësishme të theksohet se neni 13 i kësaj rregullore për tarifat për leje ndërtimi është hequr nga kjo rregullore, arsyeha pse është hequr është se udhëzimi administrativ 08/2018 parashev procedurat për përcaktimin e aktit për përcaktimin e tarifave komunale për leje ndërtimi, ne kishim një akt të vlefshëm që përcaktonte ato tarifa, por Ministria konsideroi se nëse do të mbesin të tilla do të konsiderohet se janë miratuar sërisht si të tilla, kështu që vendosëm që tarifa për lejen e ndërtimit të miratohet më vonë në këtë kuvend. Dua të theksoj se propozimi i Ministrisë së Arsimit që këto tarifa të janë të përcaktuara mirë sipas ligjit, por ne kemi bërë një ndryshim në udhëzimin administrativ 018/2017, këto tarifa janë të njëjta, vetëm thirrja është ndryshuar. Ky është një shpjegim i shkurtër nëse dikush ka ndonjë pyetje, unë jam këtu për t'iu përgjigjur.

Pika e radhës ishte pika e ndryshme dhe po ashtu pika e fundit në këtë seancë nuk u lakmeruar askush për fjalë, kështu që kryetari i Kuvendit z. Predrag Grbic mbylli seancën e tetë të rregullt.

Procesmbajtësi

Staja Markovic

Kryesuesi i K.K.

Predrag Grbic

